REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1087/20
Datë/Datum. 31.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili	15.12.2019	*31.12.2020*	1087/20
	Data e autorizimit të ekspertit	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës:*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datë 11.12.2020, OE :"**D.P.H Luzern**", ka parashtruar ankesë në OSHP me nr.**1087/20**, kundër njoftimit për dhënie të konratës, në lidhje me aktivitetin e prokurimit "**Shërbime hoteliere me pije Lot.1**", me numër të prokurimit: **214-20-1607-2-1-1** iniciuar nga **Autoriteti Kontraktues– Ministria e Punëve të Brendshme.**

Data e njoftimit për kontratë 24.04.2020, data e e hapjes së ofertave 12.06.2020, njoftimi për vendimin e AK-23.07.2020, Vendimi mbi refuzimin e Kerkeses per rishqyrtim: 28.07.2020.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti shqyrtues ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore sipas nenit 113, te LPP-së.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e ligjit te prokurimit publik,te shkelura nga autoriteti kontraktues "MINISTRIA E PUNEVE TE MBRENDSHME"gjate keti aktiviteti te prokurimit per LOT-l"Sherbime hoteliere me pije per LOT-1" me numer prokurimi 214-20-1607-2-1-1 dhe me nr. te mbrendshem 214/20/008/211 jane si vijon:

NENI-7- BARAZIA NE TRAJTIM

NENI-27-DOSJA E TENDERIT.ZBATIMI I RREGULLORES SE SPECIFIKACIONEVE TEKNIKE,KRITEREVE TE DOSJES SE TENDERIT.
NENI -28—SPECIFIKIMET TEKNIKE

NENI-51-NJOFTIMI PER KRITEREVE PER DHENJE TE KONTRATES
NENI-52-NJOFTIMII KRITEREVE PER DHENJE TE KONTRATES
NENI-56-DISPOZITAT E PERGJITHESHME MBI ZGJEDHJEN E PJESEMARRJEVE DHE DHENIE TE KONTRATAVE

NENI-59-EKZAMINIMI,VLERESIMI DHE KRAHASIMII TENDEREVE
NENI-60-KRITERET PER DHENJE TE KONTRATES
NENI-64-DESHMITE E KERKESAVE

NENI-69-AFTESIA TEKNIKE DHE/PROFESIONALE

Duke ju referuar ligjit te prokurimit publik te Republikes Se Kosoves, sipas nenit 109 te ligjit nr.04/1-042 per prokurimit publik,i ndryshuar dhe i plotesuar me ligjin nr.04/1-237,ligjin nr.05/1-068 dhe ligjin nr. 05/1-092 kompania D.P.H. LUZERN,argumenton,sqaron dhe e elaboron me fakte konkrete te bazuar ne ligjin e prokurimit publik,te paragrafet 9.1.b. dhe 9.2.b. ne faqen 18-19 te dosjes se tenderit me nr. prokurimi 214-20-1607-2-1-1 dhe me nr. te mbrendshem 214-20-008-211 me titull- "Sherbime hoteliere me pije per lot-1"

1. Kompania D.P.H. LUZERN -eshte ne perputheshmeri te plote me nenin 27 dhe 28 te ligjit te prokurimit publik te Republikes Se Kosoves,dhe plotesisht e permbushur me rregullat specifike teknike te kritereve ne dosjen e tenderit me titull -sherbime hoteliere me pije per lotl
2. Kompania D.P.H. LUZERN-Ploteson krejtesisht kriteret te cilat jane te percaktuara ne dosjen e tenderit per LOT-l,sipas nenit 51 te ligjit te prokurimit publik te Republikes Se Kosoves, nga autoriteti kontraktues ne njoftimin per kontrate te dates 24.04.2020 permes platformes elektronike-E-prokurimi.
3. Kompani D.P.H. LUZERN-duke ju referuar njoftimit per kontrate si dhe percaktimit te kritereve ,soecifikacionit lendor te dosjes se tenderit me titull -sherbime hoteliere me pije per LOT-l,si dhe duke ju referuar dhe analizuar me hollesi kriteret e lendes se kontrates,paraqesim fuqishem argumentet te bazuar mu ne lenden e dosjes se tenderit te mberthyera me kriteret e saj,konstatojme se kemi dorezuar deshmi te bollshme te kerkesa mbi mundesit teknike /profesionale te paragrafet 9.1 .b. dhe 9.2.b. te faqeve 18-19

Duke u bazuar fuqishem ne nenit 59-ekzaminimi,vleresimi dhe krahasimi i tendereve,ne njoftimin per kontrate si dhe ne dosjen e tenderit e shohim qarte se per tenderin me titull- sherbimet hoteliere per lot 1-eshte kerkuar sherbime vetem per pije e kursesi me ushqim,per kete bazohemi ne dosjen e tenderi ku ne menyre te qarte thuhet:se vendi i kryerjes se sherbimeve per LOT-1 ka te beje me pije pra te lenda e kontrates pra pershkrimi NENI ILLENDA E KONTRATES-Ku thuhet :Vendi apo vendedodhja e puneve per sherbime te LOT-l-eshte 1 Me pije ne ndertesen qendrore e Ministrise se puneve te Mbrendshme,adresa "Luan Haradinaj"pn e cila ndodhet prane stadionit te qytetit se Prishtines,2.ME PIJE NE OBJEKTIN E AGJENCISE SE REGJISTRIMIT ME "ADRES LUAN HARADINAJ" DHE DEPARTAMENTI I PRODHIMIT TE PASAPORTAVE NE OBJËKTIN E ISH -GERMISE NE PRISHTINE-PRA KJO ESHTE PER SHERBIMET HOTELIERE PER LOT -1 KU NE KEMI KONKURUAR PRA KETU KA TE BEJE VETEM ME SHERBIME ME PIJE NDERSA ESHTE SHUME DOMETHENES FAKTI QE TE CEKET SE KY TENDER ESHTE I PERBERE PREJ DY LOTE, KU LOTI -1 KA TE BEJE VETEM ME SHERBIME ME PIJE KURSE LOT-2 KA TE BEJE ME SHERBIME ME PIJE-USHQIM PRA KJO LENDE E KONTRATES ESHE SHUME E KRISTALIZUAR DHE CKA ESHTE SHUME E RENDESISHME TE THEKSOHET SE NE SI KOMPANINUK KEMI KONKURUAR APO OFERTUAR NE DY LOTE POR VETEM NE NJE LOT PRA NE LOTIN E PARE QE KA TE BEJE ME SHERBIMET HOTELIERE ME PIJE NE KETO QEDRA TE CILAT NUK KANE FARE KUZHINE POR KANE HAPSIRA VETEM PER SHERBIME ME PIJE,KURSE LOT -2 KA TE BEJE ME USHQIM PRA MUND TA SHIHNI EDHE NE PERSHKRIMIN E LENDES SE KONTRATES KU THUHET SE PER LOT -2 DUHET TE SHERBEHET NE QENDREN E AZILIT NE MAGURE,QENDREN PER MBAJTJE PER TE HUAJ PRA NE KETO VENDE ESHTE SHERBIMI ME PIJE DHE USHQIM

Dëmet Materiale :

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1	**Kërkesat :** Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet te ketë Stafin profesional për shërbime për këtë kontratë, me sa vijon: *1.* Operatorit ekonomik pjesëmarrës, duhet ti ketë të punësuar minimum: a. 1 (një) teknolog të ushqimit me diplomë Master ose Bachelor, me përvojë pune minimumi 3 vite në profesion, mas diplomimit, kërkohet vetëm për OE pjesëmarrës për LLOT-2. *b.* **3 (tre) kuzhinierë të kalifikuar, me përvojë pune minimumi 3 vite në profesion** *c.* **2 (dy) ndihmës kuzhinierë të kualifikuar** *d.* 2 (dy) banakierë dhe *e.* 7 (shtatë) kamarierë; 1. OE pjesëmarrës, (kërkohet vetëm për LLOT-2), duhet të posedoj mjetet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicionin për realizimin e këtij tenderi si në vijim: a. **Automjet i mbyllur frigorifer,** minimum **2 copë.** b. Pajisjet e nevojshme për ruajtje dhe transport të ushqimit në teren (termosët) minimum **10 copë.** 3. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë së paku **dy (2)** kontrata për shërbime të ngjashme hoteliere me ushqim dhe pije, shuma e të cilave duhet te jenë minimum : Për LOT -1 = 250,000.00 €. Për LOT -2 = 350,000.00 €. të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë.
	9.2	**Dëshmitë :** 1. Një Listë tabelare e personelit e nënshkruar dhe vulosur - **(origjinal)**, të prezantohet dëshmi. a. Për teknologun e ushqimit: • Diplomën (kopje).

		• Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kerkuar. • CV. • kontratë të vlefshme të punës ose marrëveshjet e punës valide në mes të OE dhe teknologut për këtë projekt, **(kopje)**; b. <u>Për Kuzhinierët</u>: • **Diplomë ose certifikatë të kualifikimit (kopje);** • Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon përvojën e kërkuar. • Kontratë të vlefshme të punës, **(kopje)**; c. <u>Për ndihmës kuzhinierë</u>: • **Diplomë ose certifikatë të kualifikimit (kopje);** • Kontratë të vlefshme të punës, **(kopje)**; d. <u>Për banakierë</u>: kontratat e vlevshme e punës **(kopje)**. e. <u>Për Kamarier</u> : kontratat e vlevshme e punës **(kopje)**. 2. **Lista e mjeteve dhe pajisjeve teknike** të cilat janë kërkuar duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. a. Për **Automjet i mbyllur frigorifer**, të dëshmohet me fotografi dhe certifikatë (librezë) valide të regjistrimit të automjetit në emër të kompanisë ose marrëveshje mbi marrjen me qira te automjetit, ne emër te këtij projekti me validitet te kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët - (kopje). b. Fotografit me përshkrim te pajisjeve për bartjen e ushqimit- **(kopje)**. 2. <u>**Lista e kontratave, projekteve**</u> me të cilën saktësohen: shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Plotësimi , nënshkrimi dhe vulosja e <u>Aneksit nr. 6</u> te Dosjes se Tenderit, *(Origjinal)*. Listës duhet ti bashkëngjiten <u>dëshmi kopjen e certifikatës (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat dhe projektet e cekura në listë, me numër të prokurimit apo numër të kontratës dhe datën e tyre</u>

		(kopje).

Pjesa (Llot) 1 : **Shërbime hoteliere me pije**

Nr.r.	Përshkrimi preciz - specifikat teknike	NJESIA MATESE	Sasia
A	PIJE TË NXEHTA DHE TË FTOHTA- Pesha e nëntotalit 95% :		
1	Kafet (Expresso, makiato e vogël ,)	Copë	1
2	Kafet (makiato e madhe , kapucino , nes kafe , qumesht me qokollade)	Copë	1
3	Çaj -Filtër (të gjitha llojet)	Copë	1
4	Pije ne kanaqe 330 ml. (coca cola , fanta, sprite, biter limon, tonik, shëeeps, çaj i ftohtë)	Copë	1
5	Lëngje frutash paketim qelqi 250 ml. (pjeshkë, mollë , dredhëz, dardhë, ananas , vishnje, portokall ,multivitamin etj)	Copë	1
6	Ujë natyral 0.5 litër, Ujë i gazuar 0.5 litër.	Copë	1
7	Ujë natyral , i gazuar (qelq) 0.25 litër.	Copë	1
	Gjithsej nëntotali A : shuma e çmimit pa peshim prej 1- 7:		
B	Gjësendet e mëposhtme mund të porositën nga MPB-ja, në rast të eventeve të ndryshme, Pesha e nëntotalit 5% :	NJESIAM ATESE	Sasia
1	Kikirikë 150 gr	Copë	1
2	Çips (babure, keqap, krip, djegës) 140 gr	Copë	1
3	Shkopinj të njelmët 200 gr	Copë	1
4	Keks 200 gr	Copë	1
5	Keks me çokollatë 300 gr	Copë	1
6	Kifle kroasana 75 gr.	Copë	1
7	Krofne 10 gr.	Copë	1
8	Kaçkavall 250 gr	Copë	1

9	Djathë 250 gr	Copë	1
10	Perime të fërguara (domate, kungullesha, patate, karrot, qepë) 200 gr	Copë	1
11	Fli 350 gr	Copë	1
12	Mantia (me mish, me djathë) 20 gr	Copë	1
13	Proshutë 300 gr	Copë	1
14	Sallam 300 gr	Copë	1
15	Virshlle 250 gr	Copë	1
16	Qofte të skarës 30 gr	Copë	1
17	Ramstek i marinuar 200 gr	Copë	1
18	Kërpudha të fërguara 200 gr	Copë	1
19	Mish i zier me perime të ziera 350 gr	Copë	1
20	Sallat e përzier (sallat e gjelbër, domate, tranguj, karrot, ullinj, qepë, djathë, balsamiq, vaj ulliri) -200 gr	Copë	1
21	Sallat kalabreze (sallat e gjelbër, domate, djathë, speca, proshutë, ullinj, vaj ulliri) – 200 gr	Copë	1
22	Mocarella me domate- djathëra të ndryshëm – 250 gr	Copë	1
23	Kungull mishi në skarë – 130 gr	Copë	1
24	Domate të zeza në skarë – 130 gr	Copë	1
25	Kungull mishi të mbushur – 130 gr	Copë	1
26	Domate të mbushura me spinaq dhe djathë - 130 gr	Copë	1
27	File pule në mënyrë vjeneze – 200 gr	Copë	1
28	Rriska bukë me proshutë të ndryshme – 20 gr	Copë	1
29	Domate të zeza me parmezan dhe vezë - 130 gr	Copë	1
30	Verëra te ndryshme (e kuqe, e bardhë) – 100 ml	Copë	1
31	Lëngje frutash 1 L, (pjeshkë, mollë, portokall, dredhëz, dardhë, ananas , vishnje, etj)	Copë	1
32	Lëngje frutash 1.5 L, (pjeshkë, mollë, portokall, dredhëz, dardhë, ananas , vishnje, etj)	Copë	1
33	Rollad (malin, dredhez, vishnje, çokollatë etj.) 300 gr	Copë	1

RAPORTI i KOMISIONIT VLERËSUES (VENDIMI PER RISHQYRTIM)

RIVLERËSIMI:

Komisioni rivlerësues duke vepruar në pajtueshmëri me Vendimin numër 537-20 të marrë nga OSHP-ja ka përfunduar rivlerësimin e ofertave, për këtë aktivitet te prokurimit dhe për Lot-1. Fitues është shpallur tenderuesi "Beni Dona Plast" SH.P.K. nga Prishtina, i cili ka dorëzuar tender të përgjegjshëm me çmimin më të ulët për njësi me peshim prej 3.96 €, sipas kriterit te përcaktuar ne njoftimin për kontrate dhe dosjen e tenderit, kurse tenderuesi ankues, D.P.H. „Luzern", edhe për kundër kërkesës nga Autoriteti kontraktues për sqarimin e tenderit, është eliminuar sepse Tenderi i tij i dorëzuar është i papërgjegjshëm sepse nuk ka dorëzuar dëshmi të vlefshme dhe të mjaftueshme te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ ose profesionale.

Në bazë të rekomandimit nga komisioni vlerësues, Departamentit të Prokurimit-MPB me datën 27/11/2020 ka dërguar për publikimin e Njoftimit mbi vendimi e Autoritetit Kontraktues të këtij aktiviteti të prokurimit dhe i ka njoftuar tenderuesit pjesëmarrës me letrat standarde për rezultatet e këtij tenderi sipas nenit 43.7 te Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik-KRPP.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KËRKUARANGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "D.P.H LUZERN"

Përgjigje në pretendimin nr.1

Pretendimi kryesorë ankimorë sipas ankesës nr.1087/20 është se i njëjti eshte ne perputheshmeri te plote me nenin 27 dhe 28 teligjit te prokurimit publik te Republikes Se Kosoves dhe plotesisht e permbushur me rregullat specifike teknike te kritereve ne dosjen e tenderit me titull -sherbime hoteliere me pije per lot.1.

Sqarojmw se me vendimin e fundit të OSHP-së lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, vendimi nr.537/20, paneli shqyrtues me rastin e kthimit të lëndës në rivlerësim, e ka obliguar AK-në që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së për të vërtetuar se të njëjtit a plotësojnë kërkesën nga neni 9.1 dhe 9.2 . Sipas vendimit për rishqyrtim, AK konform vendimit të OSHP-së nr.537/20 ka kërkuar sqarime shtesë nga

OE, ku pas paranimit të sqarimeve kanë vlerësuar se :

"*...tenderuesi ankues, D.P.H. „Luzern" edhe për kundër kërkesës nga Autoriteti kontraktues për sqarimin e tenderit, është eliminuar sepse Tenderi i tij i dorëzuar është i papërgjegjshëm sepse nuk ka dorëzuar dëshmi të vlefshme dhe të mjaftueshme te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ ose profesionale...*"

Bazuar në në rivlerësimin e AK-së dhe vendimin e kërkesës për rishqyrtim, vlerësojmë se AK kanë vepruar në pajtim me obligimet e cekura në vendim të OSHP-së nr.537/20.

OE ankues pwrmes ankesws nr.1087/20 po ashtu pretendon se :

"*...njoftimin per kontrate si dhe ne dosjen e tenderit e shohim qarte se per tenderin me titull-sherbimet hoteliere per lot 1- eshte kerkuar sherbime vetem per pije e kursesi me ushqim*"

Sqarojmë se pas nalizimit të dosjes së tenderit, tek specifikimet teknike tek Lot,1, pas pjesës "A" e cila mban 7 pozicione për pije, është edhe pjesa "B" (e pershkruar më larte në këtë raport) cila mban 33 pozicione per ushqime të ndryshme, dhe tek pjesa B , autoriteti kontraktues ka shënuar se :

"Gjësendet e mëposhtme mund të porositën nga MPB-ja, në rast të eventeve të ndryshme, Pesha e nëntotalit 5%"

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lartë vlerësojmë se pretendimet ankimore të OE ankues janë të pabazuara.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MPB
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – DPH LUZERN